

KONTRIBUTI I AKADEMIK REXHEP QOSJES PËR THEMELIMIN E SHQIPES STANDARDE

Valdet HYSENAJ

Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë, Fakulteti i Edukimit

Abstrakt

Ky punim trajton kontributin shumëdimensional të akademik Rexhep Qosjes në themelimin e shqipes standarde, jo vetëm brenda veprimtarisë për standardizimin e gjuhës së njëzuar letrare shqipe, por edhe në disa fusha me vlerë të përhershme si p. sh.: arsimore, shkencore, kulturore, historike, letrare, gjuhësore, kritike, gjithëkombëtare etj., me theks të veçantë në rolin e tij që nga Konsulta Gjuhësore të Prishtinës e mbajtur më 22 dhe 23 prill të vitit 1968, e cila paraprakisht përgatiti terrenin për Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972.

Qosja, përmes veprave të tij shkencore, kritikave letrare dhe kumtesave, përfaqëson një figure qendrore në këtë proces, duke parë shqipen jo si një gjuhë, por si një element thelbësor për unifikimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar. Megjithë pengesat e shumta politike, përfshirë ato të politikës serbe që kërkonte të ndalonte këtë iniciativë për të ruajtur ndasitë brenda shqiptarëve, përkushtimi i akademikëve si Qosja, Ajeti, Hadri etj. ishte vendimtar për suksesin e kësaj iniciative. Po ashtu, analiza përshkruan sfidat bashkëkohore me të cilat përballlet shqipja standarde dhe mbrojtjen e saj ndaj kritikave pa baza shkencore, duke vënë theksin në rëndësinë e saj si një element kyç për unifikimin kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve.

Fjalët kyçe: Rexhep Qosja, kontribut, shumëdimensional, gjuhë standarde, unifikim

(Akademiku Rexhep Qosja, përveçse një figurë qendrore në fushën e albanologjisë dhe letrave shqipe, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për konsolidimin e shqipes standarde dhe për zhvillimin e disiplinave gjuhësore dhe filologjike. Angazhimi i tij nuk kufizohet vetëm në përpjekjet për njësimin e gjuhës së shkruar shqipe, por shtrihet në një sërë fushash shkencore që kanë ndikim të përhershëm mbi identitetin gjuhësor dhe kulturor të kombit shqiptar).

Hyrje

Nga hitoria e popullit, gjegjësisht nga historia e gjuhës shqipe dimë mirë se sa ishin të fuqishme përpjekjet për njësimin e alfabetit, madje edhe para Kongresit të Manastirit, po veçanërisht aty e këtej. Po, pas këtij hapi, i cili ishte mjaft përparimtar për kohën, me gjithë të metat që i pati ky drejtshkrim, në radhë të parë, për hir të një alfabeti të përbashkët, i cili do ta shpinte gjuhën drejt njësimin, vazhduan pa ndërprerje përpjekjet për afrimin, jo vetëm të kryedialekteve, por edhe të të gjitha të folmeve e të nëndialekteve, sepse shihej se këto konvergjonin si një gjuhë, e jo siç përpiqeshin ta paraqisnin disa pseudogjuhëtarë të huaj, si dy gjuhë të ndryshme, dua të them si dy gjuhë të popujve të ndryshëm-gegërishten e Veriut dhe toskërishten e Jugut. Madje koncepte bukur të përafërta, të ndikuara nga rrethanat e atëhershme politike, janë shfaqur edhe te disa gjysmëliguistë shqiptarë, siç vërente Kostallari, në Konferencën e vitit 1952. Desha të them këtu se përpjekjet për afrimin e kryedialekteve të shqipes, në mënyrë të tërthortë, shihen edhe në dokumentet e para të shqipes, pastaj te shkrimtarët e Veriut, që nga Buzuku, Budi, Matrënga, Bardhi, Bogdani e këndej, të cilat paraqesin periudhën parakombëtare të gjuhës shqipe, me dy variantet kryesore të saj. Po lufta për gjuhën letrare mori hov gjatë Rilindjes Kombëtare. Androkli Kostallari punën e madhe për gjuhën gjatë kësaj periudhe e ka formuluar kështu: "Siç dihet, lufta për gjuhën letrare shqipe, për mësimin e lëvrimin e lirë të

saj, për njësimin, pastrimin e pasurimin e saj u bë një nga qëllimet e mjetet kryesore të lëvizjes së gjerë të Rilindjes Kombëtare”.

Gjuha letrare (standarde) shqipe që nga viti 1972, gjegjësisht që nga Kongresi i Drejtshkrimit, kur u bë njësimi i saj e deri më sot, ka arritur suksese të mëdha drejt zbatimit të definuar në të gjitha sferat e jetës shoqërore mbarëshqiptare, si në shkollë, në mjetet e informimit publik, si në ato të shkruara, ashtu edhe në ato elektronike, duke përfshirë këtu të gjitha stilet (stilin letrar, stilin shkencor, madje edhe stilin bisedor).

Mendojmë se njësimi i gjuhës letrare shqipe sipas synimeve tona: “Një popull- një gjuhë” ishte dhe mbetet edhe sot e gjithë ditën hap i madh historik drejt integritetit tonë mbarëkombëtar, pavarësisht nga ngjyrimet politike që iu dhanë e po i jipen edhe sot dhe se pa kontributin e akademik Rexhep Qosjes gjuha letrare shqipe e standardizuar nuk do të ishte kjo që është sot.

Kontributi i prof. Qosjes nuk qëndron vetëm brenda veprimtarisë për standardizimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe

Dhe, jo vetëm kaq. Jo vetëm për veprimtarinë e pasur dhe historikisht faktike e persuasive me shkrime, fjalime zyrtare, ligjërime, vepra të botuara etj. që të gjithë shqiptarët ta kenë, ta mësojnë dhe ta zhvillojnë njësimin e gjuhës letrare shqipe, porse, me të drejtë, gjuhën e pa si pjesë të kulturës në nivel kombi. Kontributi i prof. Qosjes nuk qëndron vetëm brenda veprimtarisë për standardizimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe. Jo. Ai është më i madh. Tejet i madh; ai shtrihet në disa fusha me vlerë të përhershme si p. sh.: arsimore, shkencore, kulturore, historike, letrare, gjuhësore, kritike, gjithëkombëtare etj. Veprimtaria e ndritur, e pasur, e gjerë, e lartvlerësuar shkencërisht e prof. dr. Rexhep Qosjes, në shkencat e filologjisë shqiptare, ka lënë gjurmë të përhershme në të gjitha veprimtaritë e sipërpërmendura.

Por, jo vetëm si njëri nga themelvënësit më aktivë të gjuhës së njësuar letrare shqipe që vunë bazën e patrandur të saj për të gjithë shqiptarët me Konsultën Gjuhësore të Prishtinës të vitit 1968 në krye si flamurtare e kësaj arritjeje historike gjithëkombëtare, porse edhe shumë më gjerë: si njëri nga studiuesit elitarë e lapidarë të albanologjisë në tërësi, sidomos me veprat: për romantizmin në letërsinë shqipe në tri vëllime; me veprat për kritikën letrare të letërsisë së sotme shqipe; me veprat letrare nga krijimtaria imagjinative si p. sh. vepra “Vdekja më vje prej syve të tillë” e përkthyer edhe në gjuhën frënge; vepra për zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe në rajon në të cilën shpërfaq masat represive e të dhunshme të politikës serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, sidomos që nga demonstratat e studentëve të vitit 1981 dhe në vazhdimësi deri në marrjen e autonomisë së Kosovës dhe të mbylljes së institucioneve të saj etj. si p.sh. libri “Fati i pambrojtur” i përkthyer edhe në gjuhën kroate e shumë të tjera.

Se Konsulta Gjuhësore e Prishtinës nuk qe vetëm një Konsultë thjesht gjuhësore- gramatikore, por edhe një takim i elitës shkencore, arsimore, kulturore, intelektuale etj. jo vetëm nga Kosova, porse edhe përfaqësues shqiptarë nga republikat ish-jugosllave me relevancë të veçantë historike për ndërlidhjen e bashkërendimit shkencor dhe arsimor të Kosovës me Shqipërinë që, më vonë, do të sjellë zhvillime të reja kombëtare, u pa shumë shpejt nga qarqet e politikës antishqiptare të Beogradit zyrtar, prandaj pasuan reagimet e mëdha destruktive e kundërvënëse në nivel shteti të atëhershëm për të mos e lejuar mbajtjen e Konsultës Gjuhësore, sepse, sipas politikës serbe, ajo, në realitet, do të thoshte homogjenizim gjithëkombëtar. Aksiomë. Më se e vërtetë.

Me gjithë përpjekjet dhe ndërhyrjet e politikës serbe, kjo iniciativë me vlerë të lartë historike e kombëtare, me përkushtimin e vendosur të disa akademikëve si: Idriz Ajeti, Rexhep Qosja, Ali Hadri, Fehmi Agani e shumë të tjerë, me miratimin edhe të udhëheqësve shqiptarë të Kosovës të kohës përkatëse, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës u mbajt më 22 dhe 23 prill të vitit 1968, e cila, nga rëndësia shkencore, historike, kombëtare etj. që pati, edhe sot e gjithë ditën do të qëndrojë në faqet më të ndritura të historisë shqiptare si pararendëse e Kongresit të

Drejtshtkrimi të Gjuhës Shqipe, të kësaj arritjeje madhështore historike e kombëtare që njëherës shënoi riintegrimin brendashqiptar.

Falë kontributit të flamurtarëve të iniciativës së kësaj Konsulte, profesorëve elitarë, akademikëve: Idriz Ajeti, Fehmi Agani, Rexhep Qosja, Ali Hadri etj. u shënua shmangia e provinciales në favor të gjithëkombëtares, flamurtarët tanë sollën kështu dritë të re dhe thellim të bashkëpunimit të mëtejshëm të zhvillimit të shkencave të albanistikës; duke bërë njëkohësisht hapin e parë dhe më të madh të bashkërendimit gjithëkombëtar, madje jo vetëm në fushën e standardizimit të gjuhës shqipe, por edhe të dijeve të tjera; duke hapur rrugën e bashkëpunimit shkencor Prishtinë – Tiranë; rrugën e vizitave reciproke akademike, arsimore, kulturore, hulumtuese etj., në këtë mënyrë, u jetësua programi kombëtar i Rilindjes Shqiptare: i Lidhjes së Prizrenit, Lidhjes së Pejës, Kongresit të Manastirit, Kuvendit të Junikut, shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë etj. në të cilat arritje historike, në programin kombëtar të tyre, gjuha shqipe, rrugëtimi konvergjent i saj, kishte kryet e vendit.

Kumtesa e akademik Rexhep Qosjes me titullin: **Konsulta Gjuhësore e Prishtinës dhe vetëdija kombëtare**, e paraqitur në sesionin shkecor në Prishtinë më 22 prill të vitit 2008, në të cilin morën pjesë me kumtesa shumë studiues nga Prishtina, Tirana, Shkupi etj. që shumë e thukët. Konsultën e Prishtinës prof. Qosja e vuri re nga disa këndvështrime: nga rrethanat e politikës serbe ndaj Kosovës në kohën kur u mbajt Konsulta dhe kritikën ndaj saj, nga rëndësia e kërshëria e sendërtimit të saj në Prishtinë dhe në Tiranë si një zhvillim i ri historik, shkencor e kombëtar që përgatiti terrenin për Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe etj.

Prof. Qosja, në fund të kumtesës, me shumë të drejtë, bëri edhe një vrojtim kritik ndaj të gjithë atyre që mohojnë e kundërshtojnë vlerat gjuhësore, kulturore, kombëtare, arsimore etj. të këtyre dy arritjeve madhështore: të Konsultës Gjuhësore dhe të Kongresit të Drejtshkrimit si dy nga shtyllat qendrore mbi të cilat do të pasojnë bashkërendimet risimtare shkencore, arsimore, kulturore, letrare etj. të shkallës gjithëkombëtare.

Megjithatë, këto arritje vlerash të larta tërëkombëtare edhe sot herë - herë sikur vihen në dyshim pa dëshmi shkencore nga disa “studiues”, të cilët vazhdojnë të kërkojnë kthim pas, të cilët vijnë t’i kritikojnë arritjet kombëtare dhe historike pa pasur arsye shkencore, nga disa “studiues” që nuk kanë kapital të duhur shkencor për t’u marrë me dije të reja e me nëndisiplina shkencore të filologjisë shqiptare.

Nga ky vëzhgim, akademik Qosja, edhe në këtë kumtesë, vijon të reagojë me disa pyetje retorike dhe ironike në të cilat përmbledhet implikatura befasuese dhe, logjikisht, kombëtarisht e shkencërisht, të paqëndrueshme.

Në pyetjet retorike si p. sh.: “Përse të jetë përjashtim populli shqiptar? Përse të mos ketë edhe ai një gjuhë të njësuar letrare si dëshmi e njësisë së tij dhe e funksionimit të tij si komb modern?”

Në këto pyetje retorike dhe në të tjera të këtilla akademik Rexhep Qosja shpreh konstatimin të mbështetur në të dhëna të dëshmuara gjuhësore, shkencore, kulturore, kombëtare etj. sipas të cilit Konsulta e Prishtinës e vitit 1968 shënoi hapin e madh historik të përafrimit dhe të ndërlidhjes së kombit të ndarë politikisht për uzurpime terriroresh nga politika serbe.

Tendencat që sjellin ndasi ndërshqiptare mbi baza rajonesh e dialektesh nuk u duhen shqiptarëve.

Në një nga analizat e tij, Qosja shpesh i referohej kritikave të paqëndrueshme që vinin nga disa qarqe që tentonin të minonin rëndësinë e shqipes standarde në emër të ruajtjes së dallimeve dialektore. Ai u përgjigjej me forcë këtyre kritikave, duke theksuar se një gjuhë e njësuar është një dëshmi e pjekurisë së një kombi modern dhe se shmangia nga ky kurs do të sillte fragmentim dhe dobësim të mëtejshëm të unitetit kombëtar. Ky qëndrim u konkretizua edhe në kumtesën e sipërthënë, ku ai kritikoi ata që tentonin të zhbënin këtë arritje të madhe pa argumente të vlefshme shkencore dhe i ftoi studiuesit e rinj të qëndronin mbi bazat e mirëstrukturuara shkencore që u vunë me Konsultën Gjuhësore dhe Kongresin e Drejtshkrimit.

Një tjetër aspekt thelbësor i veprimtarisë së tij shkencore që lidhet me standardizimin e shqipes është puna në fushën e drejtshkrimit. Një nga synimet e tij ishte që shqipja të mos shihej vetëm si një mjet komunikimi, por edhe si një element unifikues që do të ndihmonte në ndërtimin e një identiteti të përbashkët kulturor dhe kombëtar.

Në këtë kuadër, puna e Qosjes shfaq një thellësi të veçantë në lidhje me shkencat filologjike, duke përfshirë analizën e veprave letrare dhe gjuhësore, por edhe kontributin e tij në zhvillimin e metodologjive të reja për studimin e gjuhës dhe kulturës shqipe. Si kritik letrar, ai ndihmoi në krijimin e një platforme të re të kritikës, e cila jo vetëm që vlerësonte aspektet stilistike dhe estetike të letërsisë, por ndihmonte gjithashtu në mbrojtjen dhe përparimin e shqipes si një gjuhë kombëtare e pavarur.

Me analizën dhe veprat e tij, ndihmoi në formimin e një filozofie të re për gjuhën, duke e parë atë jo thjesht si një sistem gramatikor, por si një strukturë kulturore dhe politike që ndihmon në ruajtjen dhe forcimin e identitetit shqiptar. Ai e konsideronte gjuhën standarde si një forcë unifikuese që kapërcente kufijtë politikë të imponuar dhe ndarjet rajonale, një ide që ai e mbështeste në studimet e tij të thelluara dhe që e mbronte me bindje në çdo rast kur ajo vihej në pikëpyetje.

Rexhep Qosja gjithmonë e ka parë gjuhën si një element të pandashëm të identitetit kombëtar dhe përmes veprimtarisë së tij të gjithanshme ka treguar se zhvillimi i një gjuhe të standardizuar është thelbësor për ndërtimin e një kulture të qëndrueshme dhe të pasur.

Akademik Rexhep Qosja, me shumë vepra të botuara, ligjërata, kumtesa shkencore, fjalime publike etj., këtu e mbi një gjysmë shekulli më parë dhe në vijimësi edhe sot, është dhe do të mbetet përherë njëri nga më të merituarit për arritjet e mëdha me vlerë shkencore, historike, letrare, arsimore etj. me rëndësi gjithëkombëtare.

Sipas tij, emërtimi **“gjuhë standarde”** nuk nënkupton vetëm drejtshkrimin e drejtshqiptimit e këtij varieteti gjuhësor të ngritur në normë. Ai kap një tërësi shumë më të gjerë përbërësish dhe indeksorësh, të cilët u takojnë disiplinave e subdisiplinave shkencore jo vetëm gjuhësore, por edhe jogjuhësore p. sh. pragmalinguistika, linguistika interkulturore, sociolinguistika, kompetenca e komunikimit, semiotika, shkenca e kulturës, sociologjia e gjuhës etj., mes tjerash thotë prof. dr. **Hasan Mujaj**.

Gjuha shqipe, e njësuar, sot është ndërkombëtarizuar si e këtillë; po mësohet me kërshtëri në përmasat botërore unike për tërë kombin: ajo mund të pasurohet përditë me njësi të reja leksikore, por pa e trandur themelin e saj- tha, ndër të tjera, akademik **Idriz Ajeti**. Të mos harrohet as thënia e akademik Ali Hadrit nga Konsulta Gjuhësore e Prishtinës: **“Një komb- një gjuhë letrare”**, shprehje kjo e shkurtër nga ndërtimi, por e gjatë, shumë e gjatë nga përmbajtja. Me domethënie të përhershme. Me implikaturë semantike konvergjente. Një shprehje eliptike dhe lapidare. Nga këndvërtimi semiotik - shumë e pasur; mund të labërgohet e të vëzhgohet nga shumë fushëza të përshkrimit metaforik. Kjo shprehje duhet të ndiqet përherë, shprehet prof. dr. Hasan Mujaj.

Mendojmë se në thelb, kontributi i Rexhep Qosjes dhe i të tjerëve si ai për themelimin dhe mbrojtjen e shqipes standarde nuk është thjesht një angazhim teknik në fushën e gjuhësisë. Ai është një angazhim i thellë për ruajtjen e identitetit dhe unitetit kombëtar të shqiptarëve, një përpjekje që reflekton ndikimin e tij të përhershëm në shkencat filologjike, historike dhe kulturore. Puna e tij mbetet një pikë referimi për të gjithë ata që kërkojnë të kuptojnë dhe të thellohen në zhvillimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në një kontekst të gjerë historik e shkencor.

Në vazhdim, duhet theksuar se puna e akademik Qosjes dhe të tjerëve, është përtej një ndërhyrjeje momentale në standardizimin e gjuhës shqipe. Kjo iniciativë ka pasur një efekt të thellë dhe të gjatë në formësimin e vetëdijes kombëtare dhe të njësimi gjuhësor të shqiptarëve, një përpjekje që vazhdon të jetë thelbësore edhe sot. Qëndrimet e këtyre akademikëve, të cilët

e panë shqipen standarde si një mjet për përf forcimin e unitetit kombëtar, shënuan një epokë të re në zhvillimin e shkencave gjuhësore dhe filologjike në hapësirën shqiptare.

Që të ngrihet kultura e gjuhës standarde dhe të zbatohet në praktikë, duhet të hartohet dhe të miratohet në Kuvendin e Kosovës ligji që e mbron gjuhën standarde shqipe në të gjitha përdorimet zyrtare të saj.

Vlera më e lartë e identifikimit kombëtar- **gjuha standarde shqipe**, për të cilën kontributi i akademik Qosjes është shumëdimensional dhe i pa diskutueshëm, i cili së bashku me veprimtarët dhe gjuhëtarët më të shquar të kohës, mbollën e korrën arritje të reja të ndërtimit e të pasurimit të saj, duhet ta ketë ligjin e mbrojtjes nga ato dhe ata që bëjnë gabime të rënda në të shprehurit me gojë e të mos flasim për gabimet me shkrim që janë edhe më të rënda!

Ligjin për gjuhën standarde sot e kanë dhe e zbatojnë shtetet më të zhvilluara të Perëndimit. Pse të mos e ketë shteti i Kosovës?

Konstatime

Po ashtu, në këtë punim po paraqes konstatime pa të cilat nuk do të ishin domethënëse pa kontributin e madh të akademik Rexhep Qosjes për gjuhën shqipe.

Normat gjuhësore përsosen e përmirësohen vazhdimisht, prandaj duke qenë se ato janë të lidhura ngushtë me kulturën gjuhësore, gjatë gjithë jetës së tij njeriut i del e nevojshme të ndjekë ecjen e këtyre normave, t'i përvetësojë në kohën e duhur elementet e reja të tyre, të përditësohet gjithmonë me risitë dhe çdo gjë që ka të bëjë me kulturën e gjuhës.

Kjo vetëdije e formuar është sukses i madh në procesin e përvetësimit të normës letrare, sepse siguron ardhmërinë e gjuhës letrare, siguron përpjekjet e këmbënguljen jo vetëm për mënjanimin e lëshimeve, të shkarjeve dhe të gabimeve, por edhe përpjekjet e këmbëngulta për ngritjen e kulturës së gjuhës letrare në shkallë sa më të lartë.

Përfundim

Për rëndësinë e kodifikimit të gjuhës letrare shqipe dhe rolit të **Kongresit Drejtshkrimit** të gjuhës shqipe, në rrafshin gjithëkombëtar, pavarësisht politikave ditore që, në një mënyrë a në një tjetër, mund të jenë shfaqur aty-këtu, kohë pas kohe, në një vend a në një tjetër, varësisht nga rrethanat e ndryshme shtetërore, na duket i pranueshëm mendimi i Rexhep Qosjes, pjesëmarrës i **KDGjSH**, i cili në shkrimin **“Kongresi i Drejtshkrimit-tridhjetë vjet pas**, ndër të tjera, shkruan: *“Isha pjesëmarrës në Kongresin, që shënon njërën nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kulturës shqiptare, madje në jetën e popullit shqiptar në përgjithësi -pjesëmarrës në Kongresin që popullit shqiptar, të ndarë në katër shtete, i sillte faktorin themelor të njësisë kombëtare, të cilën nuk kishin arritur ta thyejnë kufijtë dhe, njëkohësisht, dëshminë më të sigurt të shkallës së arritur të qytetërimit”* (Gjuha shqipe,1-2, 2004, f.52 e tutje). Më duhet që këtë punim ta përfundoj me mendimin e të njëjtit autor: *“Epoka jonë është epokë e ngritjes historike të popullit shqiptar; e epokat e ngritjes historike të popujve janë epokat e pasurimit dhe të forcimit të identitetit të tyre, sepse, në radhë të parë, janë epoka të mëdha të kulturës e të gjuhës së tyre.. Ta ruajmë e ta modernizojmë gjuhën tonë standarde, sepse ashtu do ta ruajmë e do ta pasurojmë identitetin kombëtar në këtë botë të globalizimit që aq fort i kërcnon të veçantat etnike kulturore që, megjithatë, përfaqësojnë pasurinë e planetit”* (Gjuha shqipe,1-2, 2004, f.52 e tutje)..

Mendojmë, më në fund, se përpjekjet brendapërbrenda kombëtare gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, ndonëse si popull ishim të ndarë me kufij të hekurt në 5 shtete, me pjekuri dhe mençuri të pashoqe politike e shkencore, arritëm ta kemi një gjuhë standarde, d.m.th. ta kodifikojmë gjuhën standarde gjithëkombëtare, veçanërisht prej vitit 1967 deri përfundimisht më 1972 në relacionet: Tiranë-Prishtinë-Tiranë, me gjithë ndonjë mangësi të mundshme që

mund të flaket, me ndonjë ndërhyrje të vogël, me mjeshtri shkencore, me ndonjë herrje të vogël, po pa i dëmtuar sistemin gjuhësor të kodifikuar dhe të zbatuar me sukses. Dhe në këto më shumë se 56 vjet zbatimi, rezultatet janë të pamohueshme në të gjitha sferat e jetës shoqërore, me gjithë faktorët pengues gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë dhe me gjithë zërat nostalgjikë për ndonjë trajtë, që sot pothuajse ka mbetur me karakter krahinor.

Referencat

- [1]. Shaban Demiraj- Kristaq Prifti: Kongresi i Manastirit, Tiranë, 2004/.
- [2]. Hasan Mujaj, Kërkime sociolinguistike, Prishtinë, 2012.
- [3]. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968), Prishtinë, 2008.
- [4]. Konferenca shkencore, “Akademiku “ Jani Thomai..., Korçë, 2019.
- [5]. Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, Prishtinë, 2007.
- [6]. Gjuha shqipe,1-2, 2004